



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:110083

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05464558

KF.nr.573/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “New Co Mulliri Fabrika e Bukës” LLC me numër unik identifikues 810543315 dhe seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.H. avokat nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, duke vendosur lidhur me paditën e paditësit për anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me 22.02.2024, në prani të avokatit të palës paditëse H.H. dhe të përfaqësuesit të palës së paditur L.XH., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “New Co Mulliri Fabrika e Bukës” LLC me seli në Ferizaj, si e pabazuar.
- II. MBETET NË FUQI vendimi nr.prot.177/2020 të datës 03.08.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë-Departamentit të Ankesave.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës në konflikt administrativ.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 19.05.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.prot.177/2020 të datës 03.08.2020, me të cilin i është pezulluar përkohësisht shqyrtimi i ankesës me nr.177/2020 e datës 12.06.2020, deri në përfundimin e

procedurës penale, pasi ndaj subjektit është ngrit aktakuza dhe lënda është duke u shqyrtuar në procedurën penale sipas aktakuzës nga Prokuroria Themelore Ferizaj.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 02.08.2021 ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Administrata tatimore si palë e paditur në këtë konflikt administrativ, për qëllime të përgjigjes në padi i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura në padi, si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale dhe informon gjykatën se ATK nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të palës paditëse për shkak se lënda është duke u shqyrtuar në procedurë penale sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore e Ferizajt. DHTI ka kryer vlerësim tatimor për paditësin, duke u bazuar në legjislacionin tatimor, përkatësisht nenin 19 të Ligjit 03/L-222 dhe nenin 29 paragrafi 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2020, e cila dispozitë parasheh: *“Në rast kur një detyrim tatimor është përcaktuar përmes hetimit të një veprë penale në fushën e tatimeve të kryera nga njësia për Hetime Tatimore e ATK-së, Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë një vlerësim të tatimit bazuar në rezultatet e hetimit të veprës penale në fushën e tatimeve pa pasur nevojë për një procedurë kontrolli”*. ATK Departamenti i Ankesave ka kërkuar informata nga Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës-DHTI, lidhur me ankesën e paditësit të dorëzuar në DA, ankesë ndaj Njoftim Vlerësimit në TVSH dhe CD 2012, ku paditësi është njoftuar me një shkresë nga DHTI me nr. 80/2020, të datës 13.03.2020. Me datën 30.07.2020 DHTI ka kthyer përgjigje, sipas të cilës përgjigje vërtetohet se DHTI ka përfunduar kontroll që ka të bëjë me paditësin nga Ferizaj, duke bërë raport final vlerësues, dhe duke iniciuar kallëzim penal pran Prokurorisë Themelore në Ferizaj, dhe prokuroria mbi dyshimin e bazuar ka ngritur aktakuzë ndaj paditësit në këtë rast, për veprën penale shmangie nga tatimi, dhe lënda është duke u shqyrtuar në procedurë penale me nr. PP/II/ nr. 859-1/18-provë shtesë e DHTI-së 30.07.2020. Nisur nga faktet e prezantuara më lartë ATK-ja i ka propozuar Gjykatës Themelore-Departamentit Administrativ-Divizionit Fiskal që të merr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit, dhe të vërtetohet si i bazuar vendimi i DA nr. 177/2020 i datës 03.08.2020.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, me Aktgjykimin A.nr.1487/20 të datës 09.02.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar vendimi nr.117/20 të datës 03.08.2020 të Administratës Tatimore të Kosovës-Divizioni i Ankesave, dhe ka Urdhëruar organin e paditur Administratën Tatimore të Kosovës në Prishtinë që në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi në vështrim të nenit 77 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenit 132 të Ligjit

nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të merr vendim sipas ankesës së paditësit të ushtruar me datë 12.06.2020, me të cilën ka kundërshtuar Njoftim Rivlerësimet dhe të njëjtin vendim t'ia dorëzoj paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Duke vepruar sipas ankesës së të paditurës, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1167/22 të datës 31.08.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës dhe ka kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale, dhomat e shkallës së parë, me udhëzim që në rivendosje gjykata e shkallës së parë duhet ti vlerësoj dispozitat ligjore sa i përket pretendimeve të paditurës, pasi që kompetent për zgjidhjen e çështjes paraprake është Gjykata tjetër në procedurë penale për shkak të dyshimeve për vepër penale.

Gjykata, në rigjykim ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor publik me datë 22.02.2024, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

Përfaqësuesi i paditësit gjatë seancës gjyqësore, ka deklaruar se e paditua ka vepruar në kundërshtim me atë që vet ka vendosur duke e obliguar paditësin që të paguan detyrimet shtesë tatimore sipas raportit të kontrollit që do të thotë e njëjta i ka inkasuar taksat paditësit i cili ka ushtruar ankesë, ndërsa në anën tjetër shqyrtimin e ankesës e ka lidhur me përfundimin e procedurës penale. Me propozim për gjykatën që të obligoj të paditurën që të bëjë kthimin e taksave të paguara ashtu siç i ka konstatuar në raportin e kontrollit dhe të pret përfundimin e procedurës penale lidhur me këtë çështje. Në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj padinë dhe të obligoj të paditurën që të kthej mjetet e inkasuar në emër të raportit të kontrollit me të cilën është konstatuar qarkullimi dhe obligime shtesë tatimore pasi që e njëjta e ka pezulluar procedurën e shqyrtimit të ankesës ndaj të njëjtit raport derisa çështja të zgjidhet në aspektin penal për shkak të dyshimeve për shmangie nga tatimi për të njëjtat pretendime si në raportin e kontrollit të ATK-së.

Përfaqësuesja e të paditurës gjatë seancës gjyqësore ka deklaruar se e njoftojnë gjykatën se aktualisht është duke u zhvilluar procedura penale në Gjykatën Themelore Ferizaj nën dyshimin e veprës penale shmangie nga tatimi e cila ndërlihet dhe ka të bëjë me këtë çështje kontestuese me këtë konflikt administrativ. Prandaj gjykatës i ka propozuar që procedurën në këtë konflikt administrativ ta ndërpres derisa atë zgjidhet çështja penale me nr. PP/II85918, duke konsideruar se zgjidhja paraprake e kësaj çështje do ti ndihmonte kësaj gjykate në këtë konflikt

administrativ dhe me të drejtë DA ka vendosur bazuar në nenin 85 të Ligjit 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative që të suspendojnë shqyrtimin e ankesës derisa të zgjidhet çështja penale. Ndërsa lidhur me pretendimet e paditësit se ATK e ka obliguar që të paguaj detyrimet shtesë, një pretendim i tillë nuk qëndron aspak sepse ATK askënd nuk e detyron obligativisht ti paguaj tatimet përveç atyre që dalin në kuadër të raportit të kontrollit e që në rastin konkret paditësi i ka paguar obligimet tatimore. Në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të ndërpritet procedura në këtë konflikt administrativ derisa të përfundoj çështja penale.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 22.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Shënimin nga DHTI nr.8/17 i dt 13.03.2020 i nxjerrë nga ATK, Njoftimi për rivlerësim për llojin e tatimit mbi korporatat për periudhën tatimore 2012, Njoftimi për rivlerësimin e tatimit TVSH për periudhën tatimore 2011/2012, Ankesa parashtruar në ATK me nr.177/2020 e dt. 12.06.2020, Vendimi nr.177/2020 i dt.03.08.2020, Kontrata për kryerjen e punëve e dt. 10.08.2012, Transferi bankar i TEB bankës 13.12.2012, 10 Fotografii të objektit, për linjën e sistemit të gazit, Raporti i kontrollit nr.35 i dt. 15.06.2017, Raporti i kontrollit nr.35 i dt. 23.11.2017, Përgjigja në padi e dt. 02.08.2021, Emailat e ATK të dt. 30.07.2020, Tabela për faljen e borxhit nga ATK për paditësin e printuar me dt. 28.07.2021, Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK për paditësin e printuar me dt. 28.07.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara gjykata konstaton se paditësi me datë 12.06.2020, i është drejtuar të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë-Departamenti i Ankesave, me Ankesë, duke kërkuar aprovimin në tërësi të ankesës, dhe kthimin në gjendjen e mëparshme të deklaratave tatimore të paditësit të ndryshuara nga Njësia e Hetimeve tatimore si dhe të shpallen të pavlefshme dhe të anulohen njoftimet rivlerësimet për periudhën 2012 për llojin e tatimit CD dhe periudhën 11/2012 për llojin e tatimit TVSH-ë. E paditura ATK- Departamenti i Ankesave me vendimin kontestues ka pezulluar përkohësisht shqyrtimin e ankesës nr.177/2020

të datës 12.06.2020, deri në përfundimin e procedurës penale. Këtë vendim e paditura e ka mbështetur në dispozitat e nenit 85.1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me arsyetimin se rasti në fjalë është në procedurë penale.

Çështja paraprake në procedurën administrative është e rregulluar me nenin 85 të Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative me të cilin përcaktohet : *“1. Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: ”çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit. 2. Kur procedura për zgjidhjen e çështjes paraprake mund të fillojë vetëm me kërkesë të palës, vendimi për pezullimin e procedurës duhet të informojë palën për nevojën e kësaj kërkesë. “*

Nga dispozitat e lartcekura gjykata konstaton se e vendimi për pezullimin e procedurës administrative i nxjerr nga e paditura, është i drejtë dhe se e paditura ka vepruar konform dispozitave ligjore me të cilat rregullohen veprimet e organit administrativ në rast se has në pengesa për zgjidhjen e çështjes kryesore, siç është rasti konkret, zgjidhja e çështjes paraprake.

Meqenëse në konfliktin administrativ shqyrtohet ligjshmëria e aktit administrativ përfundimtar, gjykata gjeti se propozimi i të paditurës për ndërprerje të procedurës gjyqësore deri në vendimin final në çështjen penale është i pabazuar. Këtë propozim e paditura do të mund të paraqiste në rastet kur ka vendosur meritorisht në procedurën e ankesës, e jo siç është rasti konkret kur vet e paditura e ka pezulluar procedurën, dhe se pas përfundimit të çështjes penale është vet e paditura e cila duhet të vazhdojë procedurën administrative dhe të vendosë lidhur me ankesën e paditësit ndaj të cilit vendim paditësi në rast të pakënaqësisë do të ketë përsëri të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ.

Andaj, meqë në rastin konkret është kontestues vetëm vendimi me të cilin është pezulluar procedura administrative nga organi administrativ, gjykata ka për detyrë të shqyrtojë ligjshmërinë e këtij vendimi dhe jo të ndërpresë procedurën gjyqësore, sepse edhe pas përfundimit të procedurës penale gjykata do të ketë të pamundur të vendosë për një akt i cili nuk ka vendosur meritorisht mbi ankesën.

Gjykata po ashtu shqyrtoi edhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesën që të obligohet e paditura që t'i kthejë paditësit shumën e paguar e cila ka dalë nga raporti i kontrollit, mirëpo të

njëjtën e gjeti si të paqëndrueshme meqë të njëjtën kërkesë pala do të ketë të drejtë ta realizoj pasi të vendos organi administrativ në mënyrë meritore, e pastaj varësisht të gjeturave nga i njëjti, mund të parashtrij një kërkesë të tillë.

Vendimi lidhur shpenzimet procedurale u vendos në bazë të nenit 63 të LKA-së

Nga të cekurat më lart, gjykata konform nenit 43 par 2 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.573/22, datë 29.02.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.